



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1038/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Orbico” Sh.p.k., me numër biznesi 70213697 dhe seli në Lapnasellë, Prishtinë, Magjistralja Prishtinë-Shkup, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore “LM Consulting”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Ekrem Sadiku B.I, i cili operon nën emrin tregtar N.P.Sh. “ESG”, me numër unik identifikues 811281302 dhe seli në Prishtinë, Lagja Mati 1, nr. 5, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.S., avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1506/21, i lejuar me datë 26.10.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 20.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si i bazuar prapësimi i debitorit Ekrem Sadiku B.I, me numër unik identifikues 811281302, ashtu që ANULOHET PJESËRISHT Urdhri Përmbarimor P.nr. 1506/21, i lejuar me datë 26.10.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumë prej EUR 9,205.96 (me shkronja: *nëntë mijë e dyqind e pesë Euro e nëntëdhjetë e gjashtë Cent*) dhe në këtë pjesë të përmbarimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit Ekrem Sadiku B.I, me numër unik identifikues 811281302, ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 1506/21, i lejuar me datë 26.10.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, për borxhin në lartësi prej EUR 6,073.24 (me shkronja: *gjashtë mijë e shtatëdhjetë e tre Euro e njëzet e katër Cent*), MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm; Faturës nr. FSHP20-05096, e datës 17.06.2020, me datë 26.10.2021 ka lejuar Urdhrin Përmbareimor P.nr. 1506/21, me të cilin është urdhëruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 15.279.20, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme për pagesë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore aq sa do të krijohen deri në përmbareim të plotë.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbareimor me arsyetim se fatura mbi bazë e së cilës është lejuar urdhri nuk i përmban elementet e dokumentit të besueshëm. Ka shtuar se kërkesa për pagesën e borxhit si në urdhër është shkelje e marrëveshjes mes palëve sipas së cilës palët janë pajtuar që blerja të bëhet me mundësi kthimi në rast se artikujt nuk shiten nga debitori. Ka shtuar se në këtë drejtim debitori ka bërë pagesë të pjesshme prej EUR 5,050.00, ndërsa për pjesën tjetër të mallrave në vlerë prej EUR 10,229.21, të njëjtat janë në stok dhe sipas marrëveshjes mes palëve mund të kthehen tek kreditori.. Tutje, ka theksuar se kreditoi ka lëshuar edhe notë krediti të datës 15.07.2020, duke e zbritur borxhin për vlerën 4,155.97. Andaj, ka sqaruar se prej borxhit të përgjithshëm të kërkuar si në urdhër në vlerë prej EUR 15,279.20, vlera prej EUR 5,050.00 është paguar, ndërsa vlera prej EUR 10,229.21, është dashur të zbritet me kredit notë sipas marrëveshjes dhe kështu borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbareim nuk përputhet me gjendjen reale. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbareimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri i përmban të gjitha elementet sipas nenit 29.3 të LPP-së, ndërsa e njëjta, sipas marrëveshjes së palëve, është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe është pranuar nga debitori i cili të njëjtën e ka nënshkruar. Ka shtuar se kreditori disa herë ka kërkuar nga debitori pagesën e borxhit në emër të faturës, mirëpo që i njëjti nuk ka vepruar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, urdhri përmbareimor ë mbetet në fuqi, ndërsa të obligohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të përgjigjes në prapësim, në lartësi prej EUR 208.00.

Gjykata me qëllim të shqyrtimit të valditetit të prapësimit, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 15.09.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar përfaqësuesi i debitorit dhe i kreditorit.

Përfaqësuesi i debitorit, në seancën dëgjimore ka deklaruar se debitori me prova ka argumentuar që vlera e borxhit të kërkuar nga kreditori nuk përputhet me borxhin real, për arsye se debitori ka bërë pagesë të pjesshme në vlerë prej EUR 5,050.00 në llogari të kreditorit, ndërsa borxhi i përgjithshëm është dashur të minusohet edhe për vlerën e lëshuar me kredit notë në shumë prej EUR 4,155.97, ashtu që borxhi i debitorit ndaj kreditorit të mbetet në shumë prej EUR 6,073.24.

Përfaqësuesi i kreditorit, në seancë e mbajtur dëgjimore ka theksuar se prapësimi i debitorit sa i përket besueshmërisë së dokumentit përmbarimor është i pabazuar, ngase fatura është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Më tej, ka pohuar se është bërë pagesë e pjesshme e borxhit por që e njëjta pagesë është bërë pas inicimit të procedurës përmbarimore, konkretisht me datë 02.11.2021. Ndërsa, në raport me kredit notën të cilës i është referuar debitori, ka theksuar se për të njëjtën kreditori nuk është në dijeni dhe nuk e din se si ka ardhur deri tek lëshimi i kësaj kredit note, mirëpo meqenëse e njëjta ekziston, ka theksuar se tani borxhi i kreditorit është në lartësi prej EUR 6,073.24. Në fund, gjykatës i ka propozuar që urdhrin përmbarimor ta lejë në fuqi vetëm sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej EUR 6,073.24.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve palëve, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr. 1506/21, i datës 26.10.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej EUR 9,205.96, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë pjesë debitori e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit. Përkatësisht, gjykata gjen se borxhi i kërkuar në vlerë të përgjithshme prej EUR 15,279.20, sipas faturës nr. FSHP20-05096, është përmbushur pjesërisht përmes urdhër pagesës së datës 02.11.2021 në vlerë prej EUR 5,050.00, ndërsa kreditori përmes notës kreditore nr. KSHP20-01392, e datës 15.07.2020, ka zbritur nga borxhi i përgjithshëm edhe vlerën prej EUR 4,155.97, fakte këto të cilat i ka pohuar edhe vet kreditori në seancën dëgjimore, duke i propozuar

gjykatës që urdhri përmbashur të mbetet në fuqi vetëm në raport me borxhin në lartësi prej EUR 6,073.24. andaj, nisur nga një gjendje e tillë gjykata konstaton se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Meqenëse debitori ka përmbushur pjesërisht borxhin ndaj kreditorit, gjykata në mbështetje të nenit 66, paragrafi 4 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se: *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbashimore”*, dhe nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbashimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbashimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, vendosi që për pjesën e përmbushur të detyrimit në lartësi prej EUR 9,205.96, procedura përmbashimore të përfundohej.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr. 1506/21, të datës 26.10.2021, për shumën në vlerë prej EUR 6,073.24, dhe atë sipas Faturës nr. FSHP20-05096, e datës 17.06.2020, për faktin se kjo faturë mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri për përmbashim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm ngase i përmban të gjitha elementet nga neni 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbashimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbashimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbashim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbashjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbashim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se për pjesën e lënë në fuqi urdhri i lejuar nga ana e përmbashuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën objekt përmbashimi, ngase e njejta i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat me të

cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1038/22, datë 20.09.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.